



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 605/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër një personi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në orën 11:15, një person i PDK-ës, Tahir Thaqi i është drejtuar me fjalë fyese dhe këcënuese "mos e hapni gojën se nuk e dini çka ju gjen" dhe pasi që këtë e ka ndëgjuar përgjegjisi Halit Sahitaj që te mos flas as me ne e as me kërkend dhe se askujt nuk do ti jap asnjë spjegim. Gjendja ishte afër përplasjes fizike. E gjithë kjo ka ndodhur në QV 1623a Qiflak komuna e Rahovecit

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, që do të shërbente si dëshmi për rastin në fjalë.

Ne raportin e policisë me Nr. reference SPOR-02-501/10, të lëshuar nga togeri policor Osman Ismajli, lënda "Njoftim lidhur me QV në fshatin Qiflak KK Rahovec" theksohet se: "*ne procesverbalin e logon e mbajtur në dhomën komanduese në SP Rahovec nu ka kurfar rasti të raportuar sipas kohës në këtë qender të votimit për incidentin e përshkruar në ankesë. Poashtu sipas raportit policor në KKZ gjithashtu është verifikuar nepermjet zyrtareve policor se nuk ka pasur kurfar raportimi për këtë incident në KKZ. Poashtu është verifikuar edhe nga informacionet e marrura nga patrulla e policisë në atë qender votimi se atyre nuk u ka raportuar askush për incidentin që ka ndodhur dhe as që kanë kërkuar ndihmë.*"

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar ngase ankesa është e paqartë dhe e pakuptueshme pasi që nuk përmendet se ndaj kujt është kërcënuar dhe kush është i kërcënuari, por vetëm se thuhet se personi ka kërcënuar . Ky fakt konfirmohet edhe përmes raportit të policisë me Nr. reference SPOR-02-501/10, në të cilin theksohet se në QV Nr. 1623a, dt. 12.12.2010 nuk pasur asnjë problem sigurie. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 605/2010 më datën 16.12.2010.

